

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA DEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. O.g.Jedinita Org Unit Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No: Data: Datum: Date:
2 4 18.04.2017	2440 18.04.2017
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije

Ministry of Education, Science and Technology

Komuna e Deçanit

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenin 38 të Ligjit nr. 03/L-198 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82,21 tetor 2010), duke u bazuar në nenin 32 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave (22.03.2011), si dhe në pajtim me nenin 5 paragrafi 5. 4. c të Rregullores 2001/19 për degën e Ekzekutivit, lidh:

Marrëveshje Mirëkuptimi

mes

Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

dhe

Komunës së Deçanit

Neni 1

Qëllimi

1. Kjo marrëveshje e mirëkuptimit ka për qëllim vendosjen e kornizës për bashkëpunim mes MASHT dhe Komunës së Deçanit për ndërtimin e shkollës fillore dhe të mesme të ulët "Rexhep Kadrija".
2. Lokacioni i caktuar për ndërtim të objektit të shkollës fillore dhe të mesme të ulët: në fshatin Rastavicë, certifikata kadastrale me nr. UL-70505065-00111, komuna kadastrale Rastavicë, me sipërfaqe prej: 23146m².

Neni 2

Fushëveprimi

1. Marrëveshja e mirëkuptimit shërben për të vendosur termat e përgjithshëm të partneritetit dypalësh dhe kushteve mbi bazën e të cilave palët do të veprojnë gjatë dhe rreth procesit të ndërtimit të shkollës së lartcekur.

2. Bashkëpunimi në këtë fushë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në: shkëmbimin e informatave teknike dhe pajisjet me lejet e nevojshme nga Komuna, kyçjet në Infrastrukturë etj.

Neni 3 **Përgjegjësitë e MASHT-it**

1. MASHT do të shfrytëzoj fondet e QK, për të mbështetur realizimin e këtij objekti si në sigurimin e projektit; mbikëqyrjen profesionale të punimeve sipas kritereve të ndërtimit; implementimin dhe financimin.

MASHT ka këto përgjegjësi:

- 1.1. Sigurimin e projektit për shkollën fillore të mesme të ulët sipas kërkesës së DKA-së në Deçan, (projekt nga MASHT).
- 1.2. Menaxhimin e procesit të prokurimit si dhe përgatitjen e gjithë dokumentacionit (dosjes së tenderit) për kontraktim të kompanisë së ndërtimit.
- 1.3. Caktimin e komisionit për vlerësim dhe vlerësimin e ofertave për ndërtim të objektit të shkollës fillore të mesme të ulët sipas procedurave të MASHT.
- 1.4. Kontraktimin e kompanisë ndërtimore për ndërtim të objektit të shkollës fillore të mesme të ulët.
- 1.5. Udhëheqjen dhe monitorimin e implementimit të projektit përmes Departamentit të Infrastrukturës, gjegjësisht menaxherit nga Divizioni i Infrastrukturës.
- 1.6. Emërtimin dhe monitorimin e punës së komisionit për pranim teknik të punimeve në këtë objekt.

Neni 4 **Përgjegjësitë e Komunës së Deçanit**

1. Komuna e Deçanit do ti respektoj të gjitha kushtet e përcaktuara nga MASHT për të mbështetur zbatimin e këtij projekti.

Komuna e Deçanit ka këto përgjegjësi:

- 1.1. Caktimin e lokacionit me destinim të definuar për ndërtim të shkollës fillore të ulët me të gjitha vendimet dhe dokumentacionet relevante.
- 1.2. Sigurimin se lokacioni s'ka pronësi të kontestueshme.
- 1.3. Udhëheqjen, sigurimin dhe aprovimin në kohë të gjitha procedurave dhe lejet relevante (kushtet urbanistike, lejen ndërtimore, lejen urbanistike) për të mundësuar ndërtimin në kohë.
- 1.4. Udhëheqjen dhe sigurimin në kohë për të gjitha lejet dhe kyçjet në infrastrukturë nga ndërmarrjet publike.
- 1.5. Komuna zgjidh të gjitha konfliktet e mundshme me komunitet apo personat tjerë në lidhje me çështjet/problemet që kanë të bëjnë me projektin.
- 1.6. Do të caktoj një person përgjegjës nga Drejtoria e Arsimit për përcjellje të procedurave komunale dhe çështjes së infrastrukturës.
- 1.7. Bën lëshimin e lejes për shfrytëzim të objektit (pasi të jetë bërë pranimi teknik i punëve nga komisioni i ngritur nga MASHT).
- 1.8. Do të përfundojë të gjitha punët e infrastrukturës dhe hortikulturës si në vijim:

1.9. Përgatitjen e lokacionit para se të fillojnë punimet duke përfshirë rrënimin e të gjitha objekteve ekzistuese në lokacion si dhe caktimi i pikave për ndërtim të objektit.

1.10. Ndërtimin e nënkalimit (nëse kërkohet për siguri të nxënësve) punimet të bëhen para përfundimit të punimit të ndërtimit të objektit shkollor.

1.11. Trajtimin e hapësirës gjelbëruese gjatë dhe deri para përfundimit të ndërtimit të objektit.

1.12. Do ti trajtoj deponitë joformale të mbeturinave që gjenden afër lokacionit ku shkolla ndërtohet.

Neni 5

Zbatimi

Çfarëdo ndryshimi që mund të paraqitet si nevojë dhe kërkesë e përhershme gjatë dhe rreth implementimit të projektit për ndërtim të objektit të shkollës fillore të mesme të ulët, duhet të reflektoj pajtimin paraprak të palëve të përfshira në marrëveshje për pikat e caktuara.

Neni 6

Aranzhimet financiare

1. MASHT është përgjegjëse për implementim dhe financim të aktiviteteve në vijim:

1.1. Projekti (në mungesë të projektit nga Komuna) është tipik, i ekzekutuar nga MASHT në disa Komuna të Kosovës.

1.2. Ndërtimi i objektit të shkollës fillore dhe të mesme të ulët.

1.3. Inventari dhe pajisjet për objektin e shkollës fillore të mesme të ulët.

1.4. MASHT zotohet se do ti mbuloj mjetet financiare për ndërtim të objektit të shkollës fillore të mesme të ulët.

2. Komuna e Deçanit është përgjegjëse për implementim dhe financim të aktiviteteve në vijim:

2.1. Trajtimi i ujërave të zeza.

2.2. Trajtimi i depove joformale të mbeturinave.

2.3. Rregullimi i hapësirës gjelbëruese dhe mbjellja e vegjetacionit.

2.4. Ndërtimi i nënkalimit (nëse e vlerëson Komuna).

Neni 7

Termat e Mirëkuptimit

1. Data efektive: Data në të cilën nënshkruhet MM dhe nga e cila hyn në fuqi.

2. Modifikimi: Kjo MM, mund të rinegociohet, amandamentohet apo modifikohet në çfarëdo kohe me pëlqimin e palëve, në rast se paraqiten probleme të natyrës teknike dhe në rastet e mospërbushjes së obligimeve sipas kësaj marrëveshje nga palët.

3. Përfundimi: Kjo MM do të mbetet në fuqi deri sa të përfundojë ndërtimi i objektit të shkollës fillore të mesme të ulët "Rexhep Kadrijaj" në fshatin Rastavicë-KK. Deçan.

Neni 8
Publikimet dhe informatat

1. Publikimet që dokumentojnë veprimtarinë e palëve në implementimin e këtij projekti, mund të përgatiten nga njëra palë apo bashkërisht duke u siguruar paraprakisht që palët të kenë mundësi shikimi të kopjeve në **manuskript** para publikimit.
2. Publiciteti, produktet publicitare informative, intervistat, raportet dhe format e tjera të informimit janë subjekt i parimeve të lartpërmendura.

Palët nënshkruese të Marrëveshjes së Mirëkuptimit:

Prishtinë dt: 28.03.2013

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë


Xhayit Dakaj-sekretar i përgjithshëm

Komuna e Deçanit


Rasim Selmanaj, kryetar